

KRON BERANA




DIVIZIONI 21 MALORI SS-VE TË ARMATOSURA

# SKANDERBEG



KRON BERANA

DIVIZIONI 21 MALOR I SS-VE TË  
ARMATOSURA “SKANDERBEG”



BOTIMET OSHTIMA  
TIRANË MMXVIII

## **Divizioni 21 malor i SS-ve të armatosura “Skanderbeg” (Shqiptar nr. 1)**

Ideja e krijimit të një Divizioni SS të përbërë vetëm me shqiptarë u diskutua ditët e para të marsit 1944 në Gjermani. Pala shqiptare përfaqësohej nga zëvendësministri i punëve të jashtme Vehbi Frashëri dhe pala gjermane prej sekretarit shtetëror Steengraht<sup>1</sup>. Duke qenë se forcat SS ishin forca të armatosura të shtetit gjerman, ky i fundit ruante të drejtat e komandimit, armatimit, etj. Pjesa që i mbetej palës shqiptare ishte vetëm rekrutimi. Nojbaheri këshillonte që formimi të mos bëhej në Gjermani por të bëhej në Shqipërinë e veriut sepse sipas tij, “kosovarët garantonin një forcë morale vepruese kundër elementëve armiqësorë”<sup>2</sup>. Në Divizionin SS Hanxhar ndodhej një regjiment i gjithi me shqiptarë, dhe që ishte formacioni më i mirë në të gjithë Divizionin. Ai ishte shquar sidomos kundër bandave në rajonet malore. Ai u shkëput prej Divizionit Hanxhar për të qenë në dispozicion<sup>3</sup>.

Në maj të vitit 1944, Divizioni e shtriu të drejtën për rekrutim edhe në prefekturën e Tetovës<sup>4</sup>. Rekrutimi i këtij divizioni u kthye në një çështje, sepse duhej përcaktuar roli i Qeverisë së Tiranës në këtë pjesë të marrëveshjes. Gjermanët (Nojbaheri) këshillonin që Tirana të mos ishte e përfshirë në këtë rekrutim dhe ky të bëhej në mënyrë vullnetare. Gjermanët duke njohur neutralitetin e Shqipërisë në konfliktin botëror kishin interes që Qeveria Tiranës të mos kishte probleme që mund të vinin nga njohja e këtij divizioni. Tjetër gjë që shqetësonte gjermanët ishte dhe një konflikt i mundshëm midis Xhaferr Devës dhe Mehdi Frashërit. Deva duhej të ketë qenë një nga këmbëngulësit për krijimin

---

1) *Dokumente të institucioneve gjermane për historinë e Shqipërisë 1941-1944*, përgatitur nga Dr. Hakif Bajrami, Vatra, Prishtinë 1998, fl. 195-197

2) Po aty, fq. 196

3) Po aty, fq. 222

4) A. Q. Sh. i R. Sh. F. 158, V. 1944, D. 32, fl. 42

e këtij divizioni, gjë që shkonte kundër me qëndrimin e Mehdi Frashërit për të mbajtur neutralitet në këtë konflikt<sup>5</sup>.

Qëndrimi i Shtetit Shqiptar në lidhje me Divizionin shqiptar, qartësohet gjatë rekrutimit të tij. Çdo veprim për rekrutim është bërë nga zyrat ushtarake të Shtetit Shqiptar. Gjithsesi qeveria e Tiranës miratoi vendimet e Komitetit Qendror të Lidhjes II-të Prizrenit. Vendime që lejonin krijimin në tokë shqiptare të një Divizioni malor SS, apo që liroi nga mobilizimi disa ditëlindje që të ishin të gatshme për mobilizim, mbajti një qëndrim kategorik, kur persona të ndryshëm, civilë apo ushtarakë braktisën pozicionet e tyre për tu veshur SS. Ushtarakë të Baterisë Mati, Regjimenti 2, braktisën njësinë e tyre për tu veshur SS. Kjo u konsiderua si dezertim nga radhët e ushtrisë shqiptare, prandaj u kërkua prej komandës së Divizionit kthimi i këtyre ushtarëve për tu gjykuar nga gjyqi ushtarak, ashtu siç ishte bërë dhe me ushtarë të tjerë para tyre<sup>6</sup>. E njëjta gjë ndodhi dhe me ata civilë që braktisën pozicionet e tyre. Mësuesi i shkollës së katundit Deçan, braktisi punën për tu veshur SS. Kryeministrisë iu desh të bënte me dije institucionet vartëse se nuk e njeh Divizionin SS Skanderbeg<sup>7</sup>.

### *Krijimi*

Vendimi për bashkëpunim në krijimin e një Divizioni SS shqiptar u mor në një mbledhje të jashtëzakonshme të Komitetit Qendror të Lidhjes së II-të të Prizrenit mbajtur më 30 mars 1944. Mbledhja kryesohej prej kryetarit Bedri Pejani, merrnin pjesë dhe anëtarët e Komitetit, Musa Shehu, Nexhip Basha, Xhemal Kabashi, Sheh Hasani, Nuri Llahusha, Ndue Shahini, Abdyl Aga Shahini. Në mbledhje ishin ftuar gjithashtu Prefekti i Prizrenit Shaqir Curri dhe nën

---

5) Bajrami, *Vep. Përm.* fl. 198

6) A.Q. Sh. i R. Sh. F. 158, V. 1944, D. 32, fl. 18,20

7) A. Q. Sh. i R. Sh. F. 195, V. 1944, D. 34, fl. 21-23.

## DIVIZIONI 21 MALOR I SS-VE TË ARMATOSURA “SKANDERBEG”

---

nën komandanti i Sektorit “Kosova” Ndrek Pepa<sup>8</sup>. Pasi u ra dakord me krijimin e tij, çështja kryesore që u diskutua ishte mënyra e rekrutimit. Divizioni të krijohej ashtu si çdo formacion ushtarak shqiptar, përmes zyrave të rekrutimit apo ashtu si dhe propozonte Ministria e P. Brendshme, përmes rekrutimit vullnetar. Të gjithë të pranishmit ranë dakord me rekrutimin përmes zyrave të rekrutimit ashtu si të gjitha formacionet e ushtrisë Kombëtare<sup>9</sup>.

Zgjedhja e një rekrutimi përmes zyrave shtetërore argumentohej me pranimin e gjithë popullsisë së Kosovës që meshkujt prej 15-60 vjeç të mobilizoheshin prej autoriteteve prandaj dhe mundësia e rekrutimit ishte e madhe. Situata e brendshme dhe ajo e jashtme - përfunduan pjesëmarrësit në mbledhje - kërkonte një organizim ushtarak serioz dhe radikal. Një rekrutim vullnetar mund të dështojë lehtësisht, sepse mund të formohej me njerëz “të hunit dhe konopit”, ndërsa një rekrutim i organizuar nga zyrat shtetërore dhe mbështetur në ligj mund të japi një Divizion “nga më të mirët”, ku do “të përmbliidhet ajka e elementit serioz të Kosovës” si fizikisht ashtu dhe moralisht. Sistemi i vjetër i rekrutimit vullnetar duhej të merrte fund për t’ia lënë vendin një rekrutimi modern e nacionalist<sup>10</sup>. Në lidhje me rekrutimin e këtij Divizioni, vetë Komandanti i tij, kolonel August Shmithuber shpjegonte rëndësinë e të pasuri në përbërje të tij elementë të shëndoshë ku pjesa më e madhe do të ishte nga vegjëlja. Prej vegjëlisë do buronte forca e këtij Divizioni, prej këtij do të dilnin oficerët dhe nënoficerët e rinj SS<sup>11</sup>.

Rekrutimi vullnetar, por përmes zyrave ushtarake shtetërore nënkuptonte

---

8) A. Q. Sh. i R. Sh. F.147, V. 1944, D. 165, fl. 15

9) Po aty.

10) Po aty, fq. 14, 16

11) Lidhja II Prizrenit Nr. 8, dt. 4.7.1944, Organi Komitetit Qendror të Lidhjes II Prizrenit, *E vërteta!*, prej Komandantit të Divizionit Malsuer SS “Skanderbeg”, fq. 1

nxjerrjen nën lirim të disa ditëlindjeve dhe këtyre djemve tu krijohej mundësia për tu regjistruar në Divizionin SS, por gjithmonë sipas vullnetit të tyre<sup>12</sup>.

Vendimet e marra do t’i paraqiteshin për aprovim Qeverisë në Tiranë gjithashtu Komiteti Qendror i Lidhjes II-të Prizrenit do përpiquej pranë Qeverisë apo “kudo tjetër”, që Divizioni SS Skanderbeg të mos shkojë në luftime jashtë kufijve shqiptarë. Komanda e Sektorit “Kosova” do kujdesej që krijimi i këtij Divizioni të mos dëmtonte rekrutimin për formacionet e Ushtrisë Kombëtare<sup>13</sup>.

Kryeministria në Tiranë çështjen e krijimit të këtij divizioni e përcolli pranë Këshillit të Naltë për mendim<sup>14</sup>.

### *Rekrutimi*

Kushtet kryesorë për të qenë pjesë e Divizionit SS ishin, qenia i racës dhe gjuhës shqiptare<sup>15</sup>.

Rekrutimi për në Divizion, kishte nisur edhe më parë se të bëhej mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit Qendror të Lidhjes II-të Prizrenit. Ky Komitet i kërkonte Drejtorisë Rekrutimit VI-të Prizren, numrin e atyre nënshtetasve të mobilizuar nga mosha 20-30 vjeç, për prefekturat Prizren, Pejë e Prishtinë. Komiteti i kërkonte këto lista me “urgjencë” sepse parashikonte që më 15 prill 1944 të niste organizimi. Vetëm për prefekturën e Prizrenit parashikoheshin që të mobilizoheshin 1500 veta<sup>16</sup>.

---

12) A.Q.Sh. i R. Sh. F. 158, V. 1944, D. 32, fl. 9

13) Po aty, fl. 16

14) A. Q. Sh. i R. Sh. F. 147, V. 1944, D. 165, fl. 13. Dokumenti ka shënimin me dorë “Të pyetet Këshilli Ministrues se si mendon mbi çështjen që bëhet fjalë më sipër, në mbledhjen që ka me bâ pranë këtij Këshilli”.

15) A.Q.Sh i R. Sh. F. 158, V. 1944, D. 32, fl. 13

16) Po aty, fl. 1

Me urdhër të Komandantit të Mbrojtjes Kombëtare, gjeneral Prenk Previzit i kërkohet Drejtorisë së Rekrutimit VI dhe Komandës së Sektorit Kosova që ti vënë në dispozicion listat me “djelmoshat” e datëlindjeve të kërkuara, për datëlindjet që mungojnë gjenerali propozonte që Lidhja II-të Prizrenit të drejtohej direkt nëpër komuna<sup>17</sup>. Shumë shpejt, Zyra Rregullim e Mobilizim përmes Kryetarit të saj kolonel Hamid Tirana, bën një paraqitje të gjendjes së nënshtetasve shqiptarë të mobilizuar për tre prefekturat e sipërthëna duke bërë dhe propozimet përkatëse<sup>18</sup>. Ndërsa komandanti i Sektorit Kosova kërkonte nga zyrat vartëse të rekrutimit që të zbatoheshin rregullat në mënyrë kategorike. Nëse do të dalloheshin abuzime, oficerët dhe përgjegjësit “do ti jepeshin Gjyqit si sabotues në dam të brojtjes Kombare”<sup>19</sup>.

Vënia në dispozicion prej Komandës së Mbrojtjes Kombëtare të mobilizuarve në forcat e saj, për Divizionin SS, u bë me një marrëveshje midis palëve më 14 prill 1944. Marrëveshje që konfirmohet dhe nga vetë SS Brigadeführer e Generalmajor i Armëve SS e Pol. Fitzthum. Zyra përgjegjëse për rekrutimin e SS shqiptar ndodhej në Prizren<sup>20</sup>. Komandant i Divizionit u caktua kolonel August Shmithuber<sup>21</sup>.

Pjesë e këtij Divizioni, shfaqën dëshirë të bëhen dhe një pjesë e mirë e robërve që erdhën nga Gjermania. Këta robër shqiptarë u liruan me ndërmjetësimin e Shteti Shqiptar. Me të mbërritur në Tiranë një pjesë e tyre u tregua e gatshme për t’u veshur SS<sup>22</sup>. Me rastin e kthimit të këtyre robërve, vetë

---

17) Po aty, fl. 2

18) Po aty, fl. 3

19) Po aty, fl. 10

20) Po aty, fl. 4

21) Lidhja II Prizrenit Nr. 8, dt. 7.5.1944, Organi Komitetit Qendror të Lidhjes II Prizrenit, *Kthimi i ushtarëve kosovarë t’ish ushtrisë jugosllave qi ndodheshin në Gjermani si rob.* fq. 4.

22) Bajrami, *Vep. Përm.* fq. 234

komandanti i Divizionit August Shmithuber mbajti para tyre një fjalim përshëndetës<sup>23</sup>.

### *Shenjat dalluese*

Në takimin e 3 marsit midis zv. Ministrit të punëve të jashtme të Shqipërisë, Vehbi Frashëri me sekretarin Shtetëror të Rajhut të III, u diskutua edhe mbi simbolet që do të kishte Divizioni SS malor. Gjermanët duke menduar se shqiptarët, në shumicë myslimane, do pranonin ashtu si boshnjakët, simbole me përmbajtje fetare. Kjo gjë u kundërshtua me forcë nga zv. ministri Frashëri, i cili argumentoi se një përdorim simbolesh fetare do ngjallte pakënaqësi të madhe tek shqiptarët. Të pushtuar prej 500 vjetësh nga turqit, një përdorim simbolesh apo ngjyrash do t'u kujtonte shqiptarëve këtë pushtim. Shteti shqiptar, vazhdonte Vehbi Frashëri, ishte një shtet i ndërtuar mbi baza kombëtare dhe jo fetare<sup>24</sup>.

Një muaj më vonë, çështja e shenjave dalluese për Divizionin SS Malor ishte rregulluar. Ushtari SS shqiptar do të mbante në jakën e tij të djathtë përkrenaren dhe shpatën e Heroit Kombëtar, Skënderbeut. Në anën e majtë shenjat dalluese për çdo trupë SS dhe në mëngën e djathtë mburojën me stemën kombëtare shqiptare, si dhe mbishkrimin Skënderbeu<sup>25</sup>.

### *Veprimtaria e Divizionit*

Urdhrin e parë Divizioni e mori në fund të marsit. Detyra kësaj force ishte të gar-

---

23) Lidhja II Prizrenit Nr. 8, dt. 7.5.1944, Organi Komitetit Qendror të Lidhjes II Prizrenit, *Kthimi i ushtarëve kosovarë t'ish ushtrisë jugosllave qi ndodheshin në Gjermani si rob*. fq. 4.

24) Bajrami, *Vep. Përm.* fq. 195-195

25) Po aty, fq. 221



-antonte sigurinë në krahinë e Kosovës. Përveç territorit të Kosovës i shtoheshin dhe qyteti i Kukësit, Gucija dhe Bicaj, por i shkëputej qyteti i Tetovës. Çdo forcë ushtarake shqiptare e ndodhur në territorin e kontrolluar nga Divizioni, vihej nën kontroll dhe furnizohej prej tij. Linjat hekurudhore Prishtinë - Pejë dhe Shkup – Mitrovicë do të ishin gjithashtu nën sigurimin e këtij Divizioni. Kjo detyrë ishte parashikuar të zgjaste deri në maj të 1944<sup>26</sup>.

Divizioni u tregua shumë i suksesshëm kundër komunistëve në rajonin e Kosovës. Me një veprim energjik, forcat SS shqiptare shkatërruan një organizatë komuniste prej 210 anëtarësh. Ky ishte një sukses për forcat SS, sepse rritën besimin në popull dhe i lejuan të organizohej dhe forcohej ushtarakisht<sup>27</sup>. Vetë Komandanti i Divizionit kolonel August Shmithuber në një fjalim të mbajtur para një turme në qytetin e Prizrenit, tregoi për marrëveshjen që kishte me Qeverinë Shqiptare dhe arsyet që e detyruan të vepronin kundër komunistëve<sup>28</sup>.

Prania e Divizionit SS Skanderbeg në Shqipërinë Veriore (Kosovë) ndikoi në furnizimet aleate për komunistët sllavë. Që prej marrjes së lajmit të krijimit të një force SS me shqiptarë, anglo-amerikanët rritën sasinë dhe cilësinë e materialeve për sllavo-komunistët. Bandat komuniste ishin veshur mirë dhe me armatime moderne<sup>29</sup>.

Në rastin e fatkeqësisë së Pejës, ku qyteti shqiptar u bombardua nga avionët aleatë, humbën jetën mijëra të pafajshëm. Në vendin e tragjedisë shkoi për të dhënë ndihmën e parë vetë Komandanti i Divizionit kolonel August Shmithuber i cili bashkë me oficerët dhe ushtarët e tij nxorën viktimat dhe të plagosurit nga

---

26) Vjetar XXIV, *Disa dokumente për Divizionin SS “Skanderbeg”*, 1944, përgatitur nga Dr. Hakif Bajrami, Prishtinë, 1988. fq. 198

27) Bajrami, *Dokumente të institucioneve gjermane për...* fq. 264

28) Lidhja e II Prizrenit, Nr. 12, dt. 4-7-1944, Organi i Lidhjes II Prizrenit, *Nji fjalim i Komandanti të Divizionit Malsuer Skanderbeg*, fq. 4

29) Bajrami, *Dokumente të institucioneve gjermane për...* fq. 265

gërmadhat<sup>30</sup>. Gjithashtu Divizioni SS me spitalin e tij bëri të mundur që numri i viktimave të mos rritej dhe më tej. U dalluan SS e rinj, Husejn Llaziu, Ahmet Berberi, të drejtuar nga mjeku i Divizionit dhe Dr. Durmishi<sup>31</sup>.

### *Operacioni Draufgänger (Kokëkrisuri)*

Një nga ngjarjet më të rëndësishme të Divizionit SS Skanderbeg është operacioni Draufgänger. Operacioni drejtohej kundër forcave të komuniste në Malin e Zi. Ky ishte një sukses sepse paralizoi për një kohë gjithë transportin aleat që vinte për forcat sllave, SS shqiptar luftuan kundër një armiku që ishte dy herë më i madh në numër duke pasur humbje dy herë më pak se ai.

Operacioni Draufgänger<sup>32</sup> kishte si objektiv depërtimin në rrugën Morinë - Andrevicë, pushtimin e majave përreth Andrevicës, pushtimi i Beranës, dhe izolimin e bandave armike. Urdhri për fillimin e këtij operacioni Divizioni SS “Skanderbeg” e mori në 14 korrik 1944 dhe zgjati rreth 11 ditë. Veprimtaria e dendur e komunistëve dhe ngritja e një aeroporti në Beranë ishte bërë shqetësuese dhe rrezikonte seriozisht veriun e Shqipërisë (Kosovën). Çmohej se me furnizimet e anglezëve komunistët përgatiteshin për sulm<sup>33</sup>. Një sulm i papritur prej serbo-malazezëve kundër Rugovës dhe Rozhajës i kishte detyruar forcat shqiptare të tërhiqeshin pas vijës së sigurimit<sup>34</sup>. Ky sulm detyroi vetë ministrin e brendshëm

---

30) Lidhja e II Prizrenit, Nr. 24, dt. 27-8-1944, Organi i Lidhjes II Prizrenit, *Lajme të Mbrendëshme*, fq. 4

31) Lidhja e II Prizrenit, Nr. 23, dt. 20-8-1944, Organi i Lidhjes II Prizrenit, *Falenderim Spitalit të Divizionit SS Skanderbeg*, fq. 2

32) Vjetar XXIV, *Disa dokumente për Divizionin...* fq. 198.

33) Po aty, fq. 218

34) Lidhja e II Prizrenit, Nr. 13, dt. 11-7-1944, Organi i Lidhjes II Prizrenit, *Rreth sulmit serbo-malazez në anë të Rugovës e të Rozhajës*, fq. 4

zotin Xhafer Deva i cili në bashkëpunim me kolonel Shmithuber dhe drejtuesit lokalë dha udhëzime për veprime kundër serbo-malazezëve<sup>35</sup>. Operacioni do të zhvillohej në pesë faza. Ku faza e parë ishte pushtimi ose shkatërrimi i bazave furnizuese të armikut në Andrevicë. Sulmi mbi Andrevicë do të ishte dhe sulm orientues për të gjitha formacionet luftarake. Faza e dytë ishte një sulm drejt Kolashinit por me qëllim dizorjentimi për armikun<sup>36</sup>. Faza e tretë ishte sulmi mbi dy anët e lumit Lim dhe mbi Beranë. Faza e katërt vazhdimi i sulmit të përqendruar në Beranë deri në lindje përmes vijës Bukovac – Dapshiq<sup>37</sup>. Faza e fundit ishte sigurimi i territorit në perëndim të Beranës dhe në lindje të lumit Lim në lartësitë mes Oshtros dhe Gradinës<sup>38</sup>.

Operacioni ishte i një rëndësie të veçantë për situatën ushtarake në Malin e Zi, Serbinë Jugore dhe Shqipërinë Veriore. Kërkohej prej trupave vendosmëri dhe moral të lartë. Sulmet të bëheshin nga formacione të vogla dhe të armatosur lehtë. Të shfrytëzohej nata dhe befasia. Çdo veprim duhej bërë duke llogaritur detajin më të vogël nga sulmet ajrore të armikut deri tek maskimi<sup>39</sup>.

Forcat armike në këtë zonë parashikoheshin pesë divizione me rreth 7800 njerëz, përveç forcave që priteshin t’u vinin në ndihmë. Ndërsa forcat e Divizionit numëroheshin rreth 2860 njerëz, të ndihmuar dhe nga 1000 milicë shqiptarë. Këto forca ishin ndara në dy grupe luftarake, lindje dhe perëndim të lumit Lim. Në grupin e parë 2 çeta SS, batalioni granatahedhës, batalioni shkollor i motorizuar dhe një bateri xheniere, të ndara në grupe luftarake A dhe B. Në grupin e dytë bënte pjesë regjimenti i 14 gjuajtës malor, i ndarë në grupet C dhe D<sup>40</sup>.

---

35) Po aty, *Shkëlqesi Xhafer Deva në Prizren*, fq. 1

36) Vjetar XXIV, *Disa dokumente për Divizionin...* fq. 219-220

37) Po aty, fq. 221

38) Po aty, fq. 222

39) Po aty, fq. 223

40) Po aty, fq. 199

Sulmi nisi më datë 18 korrik 1944. Të katër grupet luftarake të Divizionit arritën të pushtonin objektivat e përcaktuar për atë ditë. Madje luftimet e grupit C (forcat e Regjimentit 14) ishin aq të vështira sa u arritën deri në luftime trup me trup<sup>41</sup>. Po ky grup arriti të pushtonte majën e Andrevicës pas një sulmi të nisur mëngjesin e datës 19, ora 03.00 që përfundoi vetëm në orën 09.00 me pushtimin e objektivit. Të tre grupet e tjerë vazhdonin përparimin. Grupi A pa hasur ndonjë rezistencë arriti pushtimin e dy kuotave. Grupi B pastroi gjithë terrenin përreth Visibabës por duke hasur në rezistencë të fortë dhe kishte çarë kalimin në ngushticën e lumit Lim. Ndërsa Grupi D kishte luftuar gjatë gjithë natës së datë 18 duke u gdhirë 19. Grupi i ndodhur në vështirësi, humbi një nga kuotat e fituara, por duke i ardhur në ndihmë forca të Grupit C e rifiton duke luftuar përsëri trup me trup<sup>42</sup>. Ndërkohë, milicët shqiptarë u urdhëruan të kalonin Plavë e Guci dhe të drejtoheshin për në veri, deri tek përroi Peviçica. Për sigurimin e lidhjeve të prapavijave me forcat sulmuese ishte caktuar çeta rekrutuese e Divizionit<sup>43</sup>.

Gjatë dy ditëve të operacionit, forcat e Divizionit kishin pushtuar territorin e Andrevicës, lokalitetet Borova Gllava, Zabrgjën, Frashnjevën dhe përgatiteshin të sulmonin dy anët e rrugës për në Beranë<sup>44</sup>. Gjatë gjithë ditës, forcat e Regjimentit 14, Grupet C dhe D, ishin angazhuar në luftime me armikun në majën Zulevo brdo. Gjatë luftimeve forcat SS u ndihmuan dhe nga aviacioni. Forcat e këtij Regjimenti u zëvendësuan nga forcat e Grupit E, grup që sapo ishte formuar me çetat e reja. Ky Grup, bashkë me forcat e milicisë u ngarkuan të mbronin majat e fituara. Ndërsa Regjimenti 14 përgatitej prej Andrevicës për të sulmuar më datë 21, Rujishtën<sup>45</sup>.

---

41) Po aty, fq. 200

42) Po aty, fq. 201

43) Po aty.

44) Po aty, fq. 202

45) Po aty.

Duke pasur mbështetjen e aviacionit, forcat e Divizionit SS, arritën të shtyjnë në tërheqje forcat armike (Grupi A). Ndërsa forcat e Grupit B arritën të pushtojnë Trepçen por pa bërë përparime të tjera. Sulmi Regjimentit 14 i parashikuar për të nisur më datë 21, në drejtim të Rujishtës, përfundoi me pushtimin e kësaj të fundit. Këto forca do të zëvendësoheshin përsëri nga ato të Grupit E, për të mbrojtur pozitat e fituara.

Sulmi mbi Beranë do të bëhej prej Grupit luftarak B duke pasur mbështetjen e Grupeve C dhe D. Ndërsa Grupi E i formuar me prej rekrutimeve të reja do të mbronte vijën Sllatinë – Krole – Xhuliqe, ky grup kishte për detyrë gjithashtu ndjekje dhe ngacmim të forcave armike. Komanda e Divizionit nuk kishte asnjë informacion se ku ndodhej forca kryesore e armikut. Por në përfundim të lumit Lim kishte një rezistencë të fortë prej armikut<sup>46</sup>.

Forcat armike do të kalonin në kundërsulm vetëm në datë 22. Grupi luftarak A do të sulmohej prej një force armike prej 4000 njerëzish. Këta kishin lëvizur gjithë natën dhe kishin depërtuar në vijat e sigurisë së milicisë shqiptare. Sulmi u zbraps prej forcave të grupit, edhe pse armiku ishte superior në numër dhe armatime. Vetëm në mesditë forcat e Grupit A përmes presionit dhe humbjeve të mëdha u tërhoqën. I gjithë krahu përfundimor i lumit Lim ishte nën presionin e vazhdueshëm të armikut. Pararoja e Grupit B ishte detyruar gjithashtu të tërhiqej. Prej forcave SS sulmonin vetëm batalioni xhenier dhe çetat ngacmonjëse të Regjimentit 14. Rruga Kolashin – Andrevicë ishte sulmuar gjatë gjithë ditës dhe natës. Sulme që ishin kundërshtuar nga SS e rinj të Grupit E, duke treguar dhe zotësi në veprime. Përkundrazi milicëve që ashtu si dhe në vijën mbrojtëse para Grupit A edhe këtu i kishin lëshuar pozitat e tyre<sup>47</sup>.

---

46) Po aty, fq. 203

47) Po aty, fq. 204

Në këtë situatë të gjitha trupat SS ishin nën sulmet e armikut, prandaj Komanda vendosi rigrupimet për të siguruar mbrojtjen. Kundërsulmi SS për në jug të lumit Marsevicë ishte penguar prej një rezistence të fortë të armikut<sup>48</sup>.

Sipas deklaratave të robërve armiq dhe dokumenteve të zënë, në veri dhe veriperëndim të Trepçes gjendej një divizion dhe dy brigada armike. Gjithashtu forca të mëdha armike mbanin territorin përreth Beronit. Një kolonë armike prej 1000 vetash ishte drejtuar për në Beranë dhe supozohej që në sektorin e operacionit Draufgenger të vepronin shtatë brigada armike, pesë prej tyre në sulm drejt juglindjes së Limit dhe dy të tjera në anët e rrugës Andrevicë - Kolashin. Komanda Divizionit çmonte se këto forca nuk ishin drejtuar kundër operacionit Draufgenger<sup>49</sup>. Divizioni do vazhdonte të mbante pozitat e fituara për të krijuar mundësinë e fillimit të një operacioni të dytë (operacioni Ricebal)<sup>50</sup>.

Prej grupeve luftarake, Grupi A ishte detyruar të tërhiqej deri në lartësitë e Çakorrit, kjo sepse nuk kishte mundësi të krijonte vija sigurimi. Përballë këtij Grupi ndodhej një fuqi prej 4000 vetash, numër që i kishte kaluar parashikimet. Nga luftimet e bëra, ky grup pati shumë humbje, të cilat mund të zëvendësoheshin vetëm 24 orë më vonë. Përforcim që do të vinte nga çetat e reja të rekrutuara. Komanda e Divizionit çmonte që Grupi A mund edhe të ishte izoluar në lartësitë e Çakorrit. Në lindje të Limit vija mbrojtëse i ishte lënë çetave të reja të rekrutuara (Grupi E), por dhe këto të pa armatosura mirë në raport me armatimin e armiku, pasi u mungonte armatimi i rëndë<sup>51</sup>. Komanda Divizionit çmonte dy mundësi veprimi. E para, që forcat kryesore të operacionit Draufgänger të vazhdonin sulmin në Beranë, pa marrë parasysh mungesën e sigurisë në prapavija.

---

48) Po aty, fq. 205

49) Po aty.

50) Po aty.

51) Po aty, fq. 206

## DIVIZIONI 21 MALOR I SS-VE TË ARMATOSURA “SKANDERBEG”

---

Me këtë mundësi sukcesi sigurohej por i gjithë Divizioni do të shkëpuste lidhjet dhe do ti lejonte armikut ti afrohej Sanxhakut dhe të vinte në rrezik një autokolonë me 100 automjete. Komanda çmonte se ndërkohë sulmi në Beranë do të ishte i kotë sepse armiku e kishte zbrazur nga forcat dhe materialet, vërtetuar kjo edhe nga deklaratat e robërve. Mundësia e dytë ishte tërheqje e formacioneve sulmuese në vijën e Limit dhe lartësitë e Andrevicës. Me këtë manovër garantohej liri veprimi për Regjimentin e 14, gjithashtu armiku izolohej dhe me lartësitë e siguruar mundej të mendohej për operacionin tjetër Ricebal. Komanda Divizionit vendosi për mundësinë e dytë<sup>52</sup>.

Grupet u vendosën në pozicione mbrojtëse, me Grupin luftarak “Rudno” (Grupet B dhe E) në mbrojtje të vijës Andrevicë – Gjuliçë. Kurse Regjimenti 14 SS përkundrazi ndodhej në sulm në vijën Visibaba – Morinë, për të garantuar lidhjen me Grupin A. Duke shfrytëzuar natën dhe linjat e dobta të sigurisë së regjimentit gjuajtës shqiptar, forcat armike arritën të çajné frontin e Divizionit dhe ta ndajnë atë në dy pjesë<sup>53</sup>. Komanda Divizionit urdhëron Regjimentin 14 SS të ndalojë sulmin dhe të garantojë me çdo kusht mbrojtjen e Visibabës. Shtabi i Divizionit bashkë me forcat e mbetura nga Grupi E do kalonin në mbrojtje të vijës Luge deri në lartësitë në perëndim të Krushevës<sup>54</sup>. Në datë 24 korrik, fronti u stabilizua. Lartësitë e lëshuara prej milicisë shqiptare u ripushtuan nga çeta rekrutuese Skanderbeg. Sulmet e armikut nga veriu dhe lindja, prej 400 njerëzish të armatosur me minahedhës e artileri, u zbrapsën me luftime deri trup me trup. Tre çeta të Regjimentit 14 SS, arritën përkundrajt një rezistencë të madhe të armikut, të siguronin vijën në lindje të Andrevicës. U lëshua vetëm një lartësi dhe kjo sepse çetat humbën komandantët e tyre dhe superioritetin të armikut

---

52) Po aty, fq. 206-207

53) Po aty, fq. 208

54) Po aty.

## DIVIZIONI 21 MALOR I SS-VE TË ARMATOSURA “SKANDERBEG”

Ndërsa Grupet B dhe E (Grupi Rudno) ishin vazhdimisht nën sulmin e armikut, i cili ishte armatosur rëndë dhe i ndihmuar nga 7 avionë bombardues. Luftimet arritën trup më trup, forcat SS u detyruan të lëshonin pozicionet duke e afruar armikun deri në skajin jugor të Andrevicës. Grupit “Rudno” ju urdhërua që të tërhiqej bashkë me të plagosurit dhe gjithë automjetet e paisjet pas vijës siguroese. Tërheqja e këtij Grupi do të garantohej nga forcat e Grupit E. Grupi “Rudno” duke pasur gjithë mbështetjen e forcave të Divizionit do të synonte të depërtonte në Visibabë<sup>55</sup>. Për fatkeqësi, urdhri tek Grupi “Rudno” shkoi i përgjysmuar, sepse radio-stacioni u humb dhe gjithë korrierët ishin vrarë. Vetëm me afrimin e errësirës, “Rudno” u vu në lëvizje bashkë me të plagosurit dhe materialet e tjera, nën mbrojtjen e batalionit SS xhenier duke hapur zjarr në të gjitha anët. Kjo e mbajti bllokuar armikun prej Andrevicë nëpër grykën e Limit e deri tek shtabi i Divizionit. Gjatë manovrës u humbën vetëm 2 kamionë. Pasi u garantua siguria e kamionëve, një pjesë e Grupit “Rudno” (Grupi B), duke i rezistuar një presioni të fuqishëm të zjarrit armik, depërtoi në vijat armike dhe mundi të sigurojë një lartësi në shërbim të manovrës për një mbrojtje rrethore<sup>56</sup>. Kësaj manovre i shtohet dhe Grupi E i cili me kundërsulm arriti lartësinë e urdhëruar<sup>57</sup>.

Forca kryesore e armikut sulmonte nga jugu dhe perëndimi i majave të Çakorrit. Sulmi ishte i mbështetur nga minahedhës dhe mitraloza si dhe armë kundërtank. Një nga majat që mbahej prej xhandarëve shqiptar u pushtua duke i lejuar armikut të depërtonte në disa pika të mbrojtjes. Si pasojë e humbjes së disa oficerëve gjermanë disa formacione ishin tërhequr dhe gjatë tërheqjes kishin zotëruar rajonin e Kuqishtës duke marrë pozita mbrojtëse<sup>58</sup>.

---

55) Po aty, fq. 209-210

56) Po aty, fq. 210

57) Po aty.

58) Po aty, fq. 211



Urdhri i ri nga Komanda e Divizionit ishte përqendrimi i të gjithë grupeve luftarake në rajonin e Ulotinës dhe organizim i mbrojtjes rrethore<sup>59</sup>.

Grupi “Visibaba” (grupi i krijuar nga forcat që vepronin në Visibaba, AB) gjatë gjithë natës duke u gdhirë 26 korriku ishte nën sulmin e armikut, sulme të zbrapsura të gjithë. Dy çeta të Regjimentit 14 SS mbështetur nga forcat e Grupit B u tërhoqën në luginën e Limit. Grupi B u urdhërua që pasditen e 25-sës të tërhiqet në vijën e sigurimit Luke – Lugë deri në perëndim të Krushevës. Edhe pse i shqetësuar nga sulme armike, tërheqja dhe organizimi i mbrojtjes është arritur. Grupi E i tërhequr drejt Plavës ka pasur gjatë gjithë natës sulme nga armiku i cili sulmonte me forca të mëdha dhe i mirë armatosur dhe ndihmuar me artileri. Kjo rezistencë e Grupit E i lejoi Komandës së Divizionit të organizojë vijën mbrojtëse. Kur Divizioni arriti të tërhiqej plotësisht, forcat e Grupit E filluan tërheqjen e tyre përmes sakrificash të mëdha dhe me humbje të shumta. Në ndihmë të kësaj tërheqjeje erdhi një çetë SS nga Ulotina. Regjimenti gjuajtës shqiptar dhe milicët u mblodhën në Morinë duke përzënë që aty forcat armike. Por në mbrëmje kjo forcë prej 500 njerëzish u tërhoq në Plavë pa bërë rezistencë ndaj armikut<sup>60</sup>.

Në këtë situatë të re, Komanda Divizionit vendosi të sulmojë përsëri drejt lindjes. Veprimtaria e armikut kishte rënë, por gjatë rrugës Morinë – Kuqishtë armiku kishte hedhur në erë të gjitha urat për të penguar kalimin e Divizionit. Ndërkohë dhe aktiviteti i aviacionit armik ishte ndërprerë dhe furnizimi i Divizionit bëhej, që prej fillimit të operacionit, prej avionëve Stuka. Sulmi nisi më 27 ora 00.00 prej Regjimentit 14 SS, i cili duke lënë dy çeta në mbrojtje të vijës Visibabë – Grabovë, u hodh në sulm të lartësitë e Shtit. Pozita pushtohet me gjithë superioritetin e armikut. Një pjesë e këtij Regjimenti, sulmoi Rzhanicën drejt Ça -

---

59) Po aty.

60) Po aty.

korrit duke pushtuar pjesën lindore të Rzhanicës së Epërme. Grupi “Rudno” tërhiqet në veri dhe perëndim të Krushevës dhe në mëngjes një çetë e tij pushton Papiqin. Ndërkohë Grupi E kishte siguruar tërheqjen e gjithë grupeve të tjera drejt perëndimit. Batalioni xhenier siguroi një urë mbi lumin Lim që mundësoi kalimin e gjithë automjeteve përtej lumit. Vija e re qëndrimit të forcave u bë Shtit – Morinë dhe vendqëndrimi i Komandës së Divizionit në Krivaçë<sup>61</sup>.

Duke siguruar mbrojtjen në perëndim, vazhdoi sulmi drejt lindjes. Regjimenti 14 SS kishte depërtuar pa ndonjë rezistencë të fortë të armikut deri në Planicë duke vënë lidhjen përsëri të Çakorrit me pjesët ballore të sulmit. Batalioni Sulmues granatahedhës pushton lartësitë përreth Morinës duke organizuar dhe mbrojtjen. Ndërsa Grupi E ishte përfshirë një një aksion pastrimi në territorin përreth fshatit Velikë. Pasi u provua që fshatarët e Velikës bashkëpunonin me bandat komuniste, u urdhërua Grupi E për rrafshimin e tij<sup>62</sup>.

Armiku kishte vënë përballë dy divizione, ku njëri përballë forcave në Çakorr dhe tjetri në Visibabë. Pjesë e këtyre forcave kanë sulmuar dhe Plavën. Vija Andrevicë – Beranë ka qenë mbrojtur nga dy divizione të tjera armike, vërtetuar kjo nga deklaratat e robërve<sup>63</sup>.

Humbjet në njerëz të Divizionit SS Skanderbeg arrinin në 100 të vrarë midis oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve dhe vullnetarëve. Të plagosur 303 dhe të humbur 454<sup>64</sup>. Ndërsa tek forcat e armikut, të vrarë të numëruar 617 dhe 600 të pakonfirmuar. Të plagosur 70 të numëruar dhe 150 të pakonfirmuar. Të zënë rob 6 vetë<sup>65</sup>.

---

61) Po aty, fq. 212

62) Po aty, fq. 213

63) Po aty.

64) Po aty, fq. 214

65) Po aty, fq. 216

Gjatë operacionit, Komanda e Divizionit vuri se se nuk kishte bërballë më banda të paorganizuar, por një forcë të armatosur me armët më moderne angleze. Në këtë pikë, armiku ka qenë superior ndaj forcave të Divizionit. Gjithashtu sllavët kishin vënë re se forcat SS nuk kishin mundësi të siguronin rrugët e furnizimeve, prandaj komunikimi me prapavijën u bë një pengesë prej tyre<sup>66</sup>.

Bashkëpunimi i banorëve vendës ka qenë një tjetër shqetësim për forcat e Divizionit. Fshati Velikë i banuar i gjithi me malazezë ndihmonte me njerëz dhe materiale banditët komunistë. Forcat SS u detyruan të rrafshonin këtë vendbanim. Armiku mbuloi cilësinë e dobët ushtarake me forcën që i garantonin armët angleze<sup>67</sup>.

Oficerët e Divizionit SS Skanderbeg, vlerësonin operacionin Draufgänger si një nga më të vështirët dhe nuk mund të krahasohej me ata të mëparshmit në luftën kundër bandave. Pasja në përbërje të tij, forca me eksperiencë në luftën kundër bandave. Kjo eksperiencë lejoi që 3 batalione e gjysmë të mbanin të gozhduar 6 divizione armike duke i shkaktuar madje dhe humbje të mëdha<sup>68</sup>.

Forcat e Divizionit SS gjatë Draufgängerit u gjendën në një terren të vështirë. Çdo ditë këtyre forcave u kërkohet të zotëronin lartësi që arrinin 800 deri në 1000 metra. Një pjesë të rëndësishme kanë pasur Regjimenti 14 SS dhe Batalioni granatahedhës, armatosur me armë kundërtank dhe topa kundërajror. Para këtyre formacioneve armiku ka bërë pak rezistencë<sup>69</sup>. Humbjet më të mëdha Divizioni i pati në regjimenti i ardhur nga Divizioni Hanxhar. Ky regjiment ishte Ky regjiment ishte më i miri i gjithë Hanxharit<sup>70</sup>, por i ndodhur para një force su-

---

66) Po aty.

67) Po aty, fq. 217

68) Po aty.

69) Po aty. Batalioni granatahedhës arriti të rrëzonte një avion gjuajtës armik. Po aty, fq. 208

70) Bajrami, *Dokumente gjermane për historinë...* fq. 222

periore në numër dhe armatim pati humbje të mëdha<sup>71</sup>.

Forcat e reja SS që rekrutonte Divizioni (Grupi E) treguan një qëndrueshmëri të madhe. Luftimet e tyre arritën trup më trup, ku dalloi çeta shkollore e nënoficerëve e cila kaloi në vetëmohim pasi humbi komandantin gjerman. Komandanti i Divizionit vërente me keqardhje se ushtarët SS shqiptarë humbën gatishmërinë e lartë ushtarake atëherë kur humbnin komandantin gjerman. Prandaj në të ardhmen ky këshillonte që humbjet e oficerëve të zëvendësoheshin sa më shpejt. Ushtria shqiptare bashkë me milicët gjatë operacionit nuk treguan asnjë vlerë ushtarake<sup>72</sup>.

---

71) Bajrami, *Disa dokumente për Divizionin...* fq. 218

72) Po aty.

---

KRON BERANA  
DIVIZIONI 21 MALOR I SS-VE TË ARMATOSURA  
“SKANDERBEG”  
TIRANË 9-V-2018  
© BOTIMET OSHTIMA